



01.Nr 109/02-2984/21

Datë: 28.09.2021

Në mbështetje të nenit 58, pika b dhe c, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 73 paragrafi 2 i Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 4 paragrafi 1 i Rregullores 02/2016 për Hapjen e Kutive të Ankesave, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HAPJEN E KUTIVE TË ANKESAVE

1. Me anë të këtij vendimi formohet komisioni për hapjen e kutive të ankesave të qytetarëve të cilat janë të vendosura në hyrje të objektit.
2. Bazuar si në piken 1 të këtij vendimi, komisioni do të përbëhet nga:
 - a. Besnik Dema;
 - b. Fatlume Selimi;
 - c. _____ (nga shoqëria civile).
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit si dhe procedurat e hapjes së kutive të ankesave janë të përcaktuar me nenin 5 dhe 7 të Rregullores 02/2016 për Hapjen e Kutive të Ankesave, andaj komisioni është i obliguar t'i aplikojë këto rregulla.
4. Komisioni ka mandat një vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve si dhe implementimi i politikave publike që shkojnë në favor të qytetarëve është synimi kryesor i yni. Duke ditur natyrën e llojllojshme të ankesave si dhe ruajtjen e privatësisë së qytetarëve tanë, kemi vendosur që në hyrjen kryesore të objektit komunal të vendosen kutitë e ankesave. Rrjedhimisht me qëllim të dëgjimit të zërit dhe dërgimin e ankesave apo sugjerimeve të qytetarëve në vendin e duhur, formohet ky komision konform Rregullores 02/2016 për Hapjen e Kutive të Ankesave.

I dërgohet:

Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme;

Anëtarëve të Komisionit;

Arkivit të Komunës.

Kryetari i Komunës
Sh. Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kaçaniku
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data	24.09.21	Vendi	KAÇANIK
II	org.	Numri	Shtojcë	
	01	400/01-29770	1.	

Në bazë të nenit 13.17 të Ligjit nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Marrëveshjes së Mirekuptimit 01.104/02-27758 të datës 08.09.2021 mes Kryetarit të Komunes dhe Shoqates për personat me aftësi të kufizuara Handikos-Kaçanik, Memorandum Mirëkuptimit mes Shoqates për personat me aftësi të kufizuara Handikos-Kaçanik dhe Shoqatës Humanitare KIF Liria nga qyteti Vaxjo-Suedi e dates 09.09.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

I

Përmes ketij vendimi, Kryetari i komunes së Kaçanikut, ndanë mjete financiare në shume prej 4,000.00 euro (katër mijë euro) Shoqates për personat me aftësi të kufizuara Handikos-Kaçanik, në emër të shpenzimeve të transportit për sjelljen e një donacioni me mjete ndihmëse – paisje dhe material shpenzues për nevojat të QKMF-së në Kaçanik.

II

Mjetet nga Neni 1 i ketij vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunes së Kaçanikut për vitin 2021 nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve, të cilat transferohen në llogarinë aktive bankare të Shoqates për personat me aftësi të kufizuara Handikos-Kaçanik.

III

Për zbatimin e ketij Vendimi do të kujdeset drejtoria e Ekonomise, Financave dhe Zhvillimit në Kaçanik.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Komunes së Kaçanikut.

Me këtë vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, dhe Shoqata për personat me aftësi të kufizuara Handikos -Kaçanik.

Më: 23.09.2021

KRYETARI I KOMUNËS SË KAÇANIKUT

